

Biseda me presidentin amerikan dhe homologët Merkel, Berlusconi, etj. Dhe vlerësimet që Obama shprehu në takimin me Haxhinaston

# Takimi Berisha-Obama, 4 çështjet e diskutuara

Kryeministri Berisha, në Samitin e NATO-s zhvilloi takime me drejtues të disa shteteve dhe qeverive. Në bisedën me shefin e Shtëpisë së Bardhë, reformat, energjia, turizmi dhe ekonomia, ishin argumentet kryesore

## EDITORIAL

**Evropa dhe SHBA, krah për krah për të ardhmen**

Nga Barack Obama

Për më shumë se gjashtë dhjetëvjeçarë europianët dhe amerikanët kanë qëndruar krah për krah sepse puna... >>> Faqe 6

## OPINION

**Lustra e fragmentuar**

Nga Albin Kurti

Më interesante të merrja vesh arsyen e kalimit të anëtarit B. nga partia politike ku kishte qenë në Lëvizjen tonë. Kisha dëgjuar për të, nuk e njihja, por u bëra kurreshtar mbase pa ndonjë arsye fort të qartë fillimisht. E zhvilluam një takim... >>> Faqe 6

## FLET SPECIALISTI

**Hipertensioni, një në tre, i prekur**

Rreth një milion shqiptarë vuanin nga hipertensioni. Pjesa dërmuese e dinë dhe kurohen, ndërsa ekziston edhe një kategori tjetër, që nuk e di se është bartës i kësaj sëmundjeje. Bashkëshoqëruar me shifrat, mjekët japin edhe këshilla... >>> Faqe 7



## Edicioni i 12-të, ja fituesit e "Këngës Magjike"

Në faqen 13 lexoni të gjitha detajet për natën finale që u mbyll në minutat e para të së dielës

## OPOZITA:

**"Protestat nisin nga Elbasani", datë e re, 26 nëntori**

>>> Faqe 5

## SHIFRAT

**Sondazhi i Gallup, shumica kundër bojkotit të opozitës**

>>> Faqe 4

## KËRKESË MASH-IT

**Pedagogët: Duam pagesë për rrezikshmëri në punë**

>>> Faqe 10

## ZV/KRYEMINISTRI:

**"Rama bëri gjynah për Bajram, mashtroi myslimanët"**

**Meta: E ftoj Ramën për një ngjalë të freskët, në Gjirin e Lalzit**

Kryetari i Partisë Socialiste është në panik nga problemet e brendshme në PS dhe deklaratat për ofertën e re politike dhe nga ana tjetër, thirrjet për protesta tregojnë mungesë serioziteti. Me këto fjalë e ka përmbledhur... Faqe 4

## NISMA E KJ-ABC

**Salihi: Liga Shqipëri-Kosovë, zgjerohet harta e futbollit**

Një ligë e përbashkët mes Kosovës dhe Shqipërisë, mbështetet fuqishëm edhe nga lojtarët e kombëtares sonë. Mjafton pak vëmendje ndaj ekipit tonë kombëtar, që përbëhet nga lojtarë kosovarë dhe shqiptarë, për të përforcuar idenë se një ligë e përbashkët... >>> Faqe 23

## INTERVISTA

**Nappi, Biella, Sorrentino: Shqipëria, mundësi pafund për investime**

Giuseppe Nappi, profesor në katëdrën e Terapisë Mjekësore dhe Mjekësisë Termale në Universitetin e Studimeve në Milano, si dhe Nicola Sorrentino, specialist i hidrologjisë dhe Dietologjisë, që aktualisht drejton Departamentin e Shkencave të Jetës pranë Universitetit European për Turizmin dhe Agostino Biella, administrator i grupit Spumador S.p.A, që operon në Itali, në një bashkëbisedim për "KJ" janë shprehur mjaft pozitivisht nga ajo ç'kanë parë deri tani në udhëtimin... Faqe 11

**EUROSIG**  
KOMPANI SIGURIMESH

ndërtim + mobilim  
**PER 50.000 € + 15.000 €**

Paguani vetëm 60 € në vit

Tel: +355 42 238 999  
Mob: +355 682079761

**INTERVISTAT/** Giuseppe Nappi, profesor në katedrën e Terapisë Mjekësore dhe Mjekësisë Termale në Universitetin e Studimeve në Milano, si dhe Nicola Sorrentino, specialist i hidrologjisë dhe Dietologjisë, që aktualisht drejton Departamentin e Shkencave të Jetës pranë Universitetit European për Turizmin dhe Agostino Biella, administrator i grupit Spumador S.p.A, që operon në Itali, në një bashkëbisedim për "KJ" janë shprehur mjaft pozitivisht nga ajo ç'kanë parë deri tani në udhëtimin disa ditë në Shqipëri



Prof. Dr. Giuseppe Nappi

Fjoralba Shahaj

**U** është eliksiri i jetës, ndaj cilësia e tij ka shumë rëndësi. Një grup investitorësh italianë, shoqëruar nga ekspertët më të mirë të fushës në vendin fqinj, me asistencën dhe konsultimin e Universitetit European për Turizmin kanë shfaqur interes për të investuar në Shqipëri në stabilimente të ujit mineral, ndaj këto ditë kanë kryer udhëtime nëpër burimet e shumta të vendit tonë, duke shqyrtuar alternativa të ndryshme për të ngritur këtë biznes. "Ky është një nga aktivitetet që zhvillon Universiteti European për Turizmin, duke vënë në kontakt tre elementë; shkencën, sipërmarrjen dhe realitetin shqiptar, për të bërë të mundur promovimin e këtij vendi dhe për të pasur sa më shumë tërheqje ndaj Shqipërisë, që ajo të pësojë sa më shpejt ngritje pozitive", tha për "KJ" rektori i EUFT, Salvatore Messina. Deri tani investitorët italianë kanë udhëtuar nëpër Shqipëri, për të parë më nga afër parametrat e ujit, zhvillimin e tregut dhe realitetin ekonomik të vendit tonë, që aspiron integrimin në Bashkimin European. Giuseppe Nappi, profesor në katedrën e Terapisë Mjekësore dhe Mjekësisë Termale në Universitetin e Studimeve në Milano, si dhe Nicola Sorrentino, specialist i hidrologjisë dhe Dietologjisë, që aktualisht drejton Departamentin e Shken-

# "Shqipëria, mundësi pafund për investime"

cave të Jetës pranë Universitetit European për Turizmin dhe Agostino Biella, administrator i grupit Spumador S.p.A, që operon në Itali, në një bashkëbisedim për "KJ" janë shprehur mjaft pozitivisht nga ajo ç'kanë parë deri tani.

**Sapo jeni përballur me Shqipërinë. A i keni studiuar paraqet uji në vendburime të ndryshme shqiptare?**

**Giuseppe Nappi:** Kemi parë analizat e ujit, kishite të dhëna që nuk ishin shumë të qarta. Mund të themi padyshim që ky ujë është i përshtatshëm për t'u futur në shishe me qëllim që të tregohet, por ka nevojë për të dhëna më të qarta, që ne po i vlerësojmë. Kështu që ne kemi vendosur që të marrim disa mostra me vete në Milano, për t'u

bërë disa analiza, sipas parametereve evropiane, në mënyrë që ky ujë të jetë mbi të gjitha i shëndetshëm për organizmin e atyre që e konsumojnë.

**Si veprohet në Itali, nëpër stabilimente të ndryshme ujërash mineralë?**

**Giuseppe Nappi:** Pasi kemi gjetur burimin e ujit, ne kryejmë analizat mikrobiologjike në katër stinë të ndryshme, për të parë që ky ujë është i qëndrueshëm. Kjo pasi nëse uji paraqet ndryshime nga njëra stinë në tjetrën, p.sh., nga pranvera në verë, nuk mund të jetë i përshtatshëm për në shishe. Më pas, duhet bërë një relacion klinik dhe hidrogeologjik për të vërtetuar cilësitë e këtij uji, për të zbuluar se nga vjen uji dhe për të evidentuar vlerat e tij. Nuk di nëse në Shqipëri funksionojnë këtë procedura, por unë them atë që ndodh aktualisht në Europë. Unë mund të them që nëse këtu do të ndërtohet kjo lloj infrastrukture për të cilën po flasim, ky produkt do të bëhet i njohur edhe në Europë, pasi do të certifikohet nga Ministria e Shëndetësisë në Itali. Duhet të dini që nëse një vend që nuk bën pjesë në Bashkimin European, atëherë ai nuk mund të dalë lirish me produktet e tij në tregun evropian.

**Pra, uji mineral shqiptar do të jetë në tregjet evropiane shumë shpejt?**

**Giuseppe Nappi:** Sigurisht, edhe pse Shqipëria nuk është ende pjesë e Europës.

**Çfarë ju shtyu që të vini në Shqipëri, për të investuar në këtë drejtim?**

**Agostino Biella:** Studiuam disa karakteristika të ujërave shqiptare, të lehta, me parametra të pëlqyeshme për t'u konsumuar



Prof. Dr. Nicola Sorrentino

edhe në BE. Ishte prof. Salvatore Messina promotori i parë që na bëri kuriozë për këtë gjë. Pamë më pas që ekzistonin kushte interesante për të zhvilluar këtë lloj industrie, duke qenë se edhe Shqipëria kërkon të rritet dhe të promovohet cilësisht në një treg evropian.

**Dhe kur mund të nisë prodhimi cilësor i ujit?**

**Agostino Biella:** Këtë vit është e vështirë të fillojmë, pasi jemi ende në fazën e studimit, të analizimit të të dhënave, për të qenë të sigurt për atë që mund të përfitojmë nga këto ujëra. Nga vlerësimi, hapat e mëtejshëm etj., do të kryhet më pas ngritja e stabilimentit në vendburim, që duhet theksuar se do ketë parametra ndërkombëtarë dhe do të jetë krejtësisht i ri, pasi ne nuk operojmë mbi bazat e atyre që janë ngritur tashmë.

**Do të jetë një sipërmarrje rivale**

**me kompanitë që veprojnë në këtë fushë në shtetin fqinj të Italisë, apo jo?**

**Agostino Biella:** Në fakt, kjo është një nga gjërat që kemi marrë në konsideratë, gjë që na shtyn të mendojmë se sikurse Shqipëria po rritet, edhe konsumimi i ujit mineral do të rritet. Kjo lë të kuptohet se në të ardhmen mund të operojmë edhe me pijet e tjera, që në Itali njohin një konsum të madh. Po vlerësojmë tregun, kërkesën e popullatës, turizmin që po ngrihet përherë e më shumë, në mënyrë që të marrim parasysh dimensionet e këtij stabilimenti. Mbi të gjitha, tregjet nuk janë vetëm lokalë, por edhe internacionalë, sidomos me fqinjët që ju rrethojnë. Mund të them që një grup pune kaq interesant dhe profesional, nuk mund të sjellë veçse rezultate pozitive për këtë sipërmarrje dhe sigurisht për Shqipërinë.

**Cili është impakti që ka uji në turizëm?**

**Nicola Sorrentino:** Uji nuk duhet parë vetëm si një pije e domosdoshme jetësore, por shumë më tej, pasi pa ujë dihet që mund të jetohej vetëm pak ditë, shumë më pak sesa pa ushqim. Uji është shumë i

rëndësishëm, por sidomos për vetitë antioksidante dhe të shëndetshme që ka, karakteristika të cilat ne po i studiojmë, sikurse u përmend edhe më lart.

**Profesor, ju drejtoni Departamentin e Shkencave të Jetës pranë Universitetit European për Turizmin, ndaj uji ka një lidhje të drejtpërdrejtë me lëndën tuaj...**

**Nicola Sorrentino:** Në fakt, shkencat e Jetës e kapërcejnë vetëm ujin, pasi lidhen me çdo gjë të shëndetshme, që nga shëndeti e gjithçka që na bën të jetojmë më gjatë, ndaj ka shumë rëndësi të hamë mirë, të pimë ujë të mirë dhe të kemi një regjim të rregullt jetësor. Ajo që dua të cek në fund të kësaj interviste është fakti që për ne është shumë i rëndësishëm prodhimi i ujit që ka karakteristika të vlefshme për shëndetin, larg nevojës së thjeshtë për ujë.



Prof. Dr. Agostino Biella